

Mbështetje për Zgjedhjet në Ballkanin Perëndimor

- Rritja e kapaciteteve të organeve të administrimit të zgjedhjeve për administrimin e zgjedhjeve në mënyrë efikase, të paanshme dhe transparente;
- Rritja e saktësisë së listave të zgjedhësve dhe proceseve të regjistrimit të zgjedhësve, duke përfshirë edhe përmes koordinimit efikas me regjistrat e popullsisë dhe kontrollit publik të listave të zgjedhësve;
- Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve të organeve rregulluese të medias për monitorimin dhe rregullimin e etikës së medias gjatë zgjedhjeve, duke kontribuar kështu për një fushatë pluraliste dhe për një mjedis të ndershëm për fushatë.

Fokusi

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) po zbaton *Projektin në Mbështetje të Zgjedhjeve në Ballkanin Perëndimor* për të mbështetur institucionet dhe shoqërinë civile në përpjekjet e tyre për të zbatuar rekomandimet e dala pas vëzhgimit të zgjedhjeve në fusha që lidhen me administrimin e zgjedhjeve, regjistrimin e zgjedhësve dhe rolin dhe punën e medias gjatë fushatës zgjedhore.

Aktivitetet

Ky projekt tre-vjeçar filloi në qershor 2017 dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim. I ofron asistencë Shqipërisë,

Bosnje-Hercegovinës, Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Projekti do të ofrojë asistencë edhe në Kosovë.*

Aktivitetet do të bazohen në rekomandimet e misioneve paraprake të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it. Zgjedhjet në Kosovë vëzhgohen nga Bashkimi Evropian dhe, në këtë rast, përdoren rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Projekti do të përfshijë tre faza: (1) fazën prezantuese (2) mbështetjen për zbatimin e rekomandimeve dhe (3) mësimet e nxjerra.

“Zyra jonë ka një histori të gjatë të mbështetjes së institucioneve dhe shoqërisë civile në zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në kohën e duhur. Me këtë projekt, shpresojmë ta intensifikojmë këtë punë dhe të mbështesim partnerët tanë në Ballkanin Perëndimor në përpjekjet e tyre të rëndësishme për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe praktikës së zgjedhjeve”.

Ingibjörg Sólrún Gísladóttir

Drejtor, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

1. Faza prezantuese

Pas një **aktiviteti prezantues me shumë aktorë** në

Varshavë, do të ndërmerren **konsultime dhe do të planifikohen disa vizita** për t'u njohur me përfituesit dhe për të diskutuar me institucionet dhe ekspertët përkatës se si mund t'u ofrojë ODIHR-i mbështetje duke iu përshtatur nevojave dhe kushteve të secilit vend. Në të njëjtën kohë, do të hartohet dhe do të publikohet online një **bazë të dhënash e rekomandimeve zgjedhore** që lidhen me këtë projekt.

2. Mbështetje në zbatim

Projekti do të vazhdojë një qasje në dy drejtime. Drejtimi i parë do të konsistojë në **seminare tematike**, organizuar mundësisht së bashku me institucionet relevante, të cilat do të ofrojnë ekspertizë të thelluar dhe përvoja krahasuese për secilën paketë rekomandimesh. Drejtimi i dytë do të konsistojë në **vizita të ekspertëve teknikë**, të cilët do të ofrojnë mbështetje më të specifikuar për rekomandime të veçanta përmes takimeve të ekspertëve me institucionet dhe me shoqërinë civile.

Përveç kësaj, do të organizohen edhe **vizita rishikimesh afatmesme** para zgjedhjeve të radhës për të vlerësuar se si janë zbatuar rekomandimet dhe për të nxitur përpjekje më intensive për zbatimin e rekomandimeve që nuk janë adresuar ende.

3. Mësimet e Nxjerra

Projekti do të përfundojë me një **proces shqyrtimi**, i cili do të përmbledhë mësimet e nxjerra, do të vlerësojë suksesin e metodave të ndryshme, do të identifikojë praktikatat e mira dhe do të dalë me disa rekomandime për përpjekjet në të ardhmen për zbatimin e rekomandimeve.

Reformë dhe Partneritet Gjithëpërfshirës

Reforma duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe duhet të udhëhiqet nga shtesa brendapërbrenda secilit vend. Ky projekt do të mbështesë mekanizmat ekzistues të reformave që përfshijnë shoqërinë civile dhe palë të tjera relevante. Vëmendje do t'i kushtohet edhe angazhimit politikisht të grupeve të papërfaqësuara sa duhet, duke përfshirë gratë, pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara.

Ky projekt do të punojë ngushtësisht me organizatat ndërkombëtare që aktivitetet të jenë plotësuese të mbështetjes që ato ofrojnë ndërkohë. Kjo do të përfshijë bashkëpunimin dhe konsultimin e ngushtë me Operacionet e OSBE-së në terren, Delegacionet e BE-së dhe mbështetësit e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara të parimeve të Vëzhgimit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve.

Konteksti

Që prej Samitit të Stambollit të vitit 1999 e më tej, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar për të ndjekur vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet. Ata kanë njohur, gjithashtu, edhe ndihmën që ODIHR-i mund t'u ofrojë në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit zgjedhor. ODIHR-i ka mbështetur vazhdimisht zbatimin efikas të rekomandimeve dhe *Manuali i vitit 2016 për Ndjekjen e Ecurisë së Zbatimit të Rekomandimeve Zgjedhore* përshkruan qasjen e ODIHR-it në këtë fushë të rëndësishme. BE-ja, duke vlerësuar rëndësinë e reformave demokratike në kuadër të aspiratave për integrim evropian në këtë rajon, ka theksuar gjithashtu edhe mbështetjen për zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it.

Informacion kontakti

Për më shumë informacion rreth projektit, ju lutem vizitoni <http://www.osce.org/odihr/support-to-elections-in-western-balkans> ose kontakttoni wb-project@odihr.pl

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike Dhe të Drejtat e Njeriut Marrëdhëniet me Publikun

Miodowa 10
00-251 Varshavë/Poloni
Tel.: +48 22 520 0600
Fax: +48 22 520 0605
E-mail: office@odihr.pl
www.osce.org/odihr

Funded by the European Union



Implemented by the OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights



With funding from the Austrian Development Agency